



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2811 Prot

Shkodër, më 08.09.2025

V E N D I M

Nr. 231 Datë 08.09 2025

**“PËR SHPALLJEN E KRITEREVE PËR KONKURSION PËR POZICIONIN E
ADMINISTRATORIT TË USH-SË “**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të larta në Republikën e Shqipërisë", neni 49 pika f, Ligji nr.8480 datë 27.05.1999 "Për funksionin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" Bordi i Administrimit të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" me cilësinë e organit më të lartë drejtues administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative, pasi diskutoi për nevojën e riorganizimit sipas kërkesës të ligjit nr:80/2015. Në këtë linjë në kuader të detyrave që ligji ngarkon Bordin e Administrimit vëren se duhet të procedohet me shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së" dhe caktimin e kriterëve dhe procedurave për emërimin e administratorit. Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës për shpalljen e konkursit për pozicionin e punës "Administrator i USH-së"
2. Miratimin e kriterëve të vlerësimit të kandidatëve në konkurimin për pozicionin "Administrator i USH-së" sipas materialit bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrian Leka

